
REFERATE E KUMTESA

MARENGLLEN VERLI**POZICIONI I AUSTRO-HUNGARISË PËR ÇËSHTJEN
SHQIPTARE NË NËNTOR-DHJETOR 1912, PRELUDI
I QËNDRIMIT NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE
NË LONDËR***

Qëndrimi i Austro-Hungarisë për çështjen shqiptare, në dekadat e fundit të sundimit osman është i njohur. I lidhur me vlerësimet gjeostrategjike për rajonin qendror e perëndimor të Ballkanit, ky qëndrim i Vjenës ka konsistuar në ruajtjen e *status quo*-së në rajon dhe prandaj në mosaprovimin e kryengritjeve shqiptare antiosmane, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, në mbrojtjen e viseve shqiptare dhe nxitjen e emancipimit dhe arsimimit kombëtar të shqiptarëve përballë ekspansionit të gjithanshëm sllav¹.

Në këtë kuadër Perandoria Dualiste ndërhynte vazhdimisht pranë Portës së Lartë që ajo të modelonte politikat e administrimit të viseve shqiptare, gjithashtu mbante nën presion fqinjët agresivë të shqiptarëve të njohur si aleatë të Ruisë, tregtonte me viset shqiptare e investonte në to më shumë se çdo Fuqi tjetër e Madhe. Njëherësh, Vjena, nxiste botimet në gjuhën shqipe dhe madje sponsorizonte intelektualë, arsimtarë e klerikë shqiptarë si Gjergj Fishta, Dervish Hima, Ndre Mjeda, Gjasim Qeriaz, Mihal Lehova, Kristo Dako, Fadil Toptani, Matë Logoreci, Lazër Lumezi etj., për të çuar përpara zhvillimin e arsimit dhe të kulturës kombëtare shqiptare².

* Kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë të organizuar në Tetovë nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, më 26-27 shtator 2013.

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.II, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 255; *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Dokumente diplomatike të Arkivit të Vjenës, *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politiches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSStA.PA.A.*), vitet 1878-1912.

² *Po aty*; Shih edhe *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, vëll.I-VII, Botimet Albanologjike, Tiranë: “Kristalina&KH”, 2012, 2013.

Shkurt, politika e Vjenës synonte në këtë periudhë statukuonë politike në Ballkan dhe përmirësimin gradual të situatës në viset shqiptare në çdo aspekt, duke e kthyer kombin shqiptar në një barrierë përballë një invazioni të ardhshëm ushtarak sllav.

Përmirësimi i situatës në Shqipëri, që mund të arrihej me këshillat dhe politikën austro-hungareze deri në mesin e vitit 1912, ishte jo vetëm në të mirë të saj, gjithashtu në të mirë të shqiptarëve, por edhe në interes të administratës osmane. Por, Perandoria e Orientit në këtë kohë nuk ishte më e aftë për të bërë punë të mëdha e aq më pak punë të mira.

Politikës së Austro-Hungarisë duhet t'i njihet merita që në trevat shqiptare e, natyrisht, në radhët e elitës politike shqiptare, të maturohej, të forcohej e të kualifikohej në politikë rryma kombëtare dhe të mbizotëronte pikëpamja për të punuar në perspektivë për autonominë e Shqipërisë.

Sot mbi një bazë të gjerë dokumentare, përfshi edhe dokumentacionin shumë të pasur diplomatik austro-hungarez, duke njohur në shumë dimensione periudhën e fillimshekullit XX, duket qartë se alternativa e autonomisë ishte për momentin e vetmja alternativë racionale. Mendimtarët më të pjekur shqiptarë ishin kështu në sinkron me Vjenën, që llogariste se copëtimi krahinor, fetar dhe ekonomik i shqiptarëve, pesha e madhe e rrymës osmaniste jokombëtare, lobizmi centrifugal i derivateve të rrymës kombëtare, niveli i ulët arsimor e kulturor i shumicës së popullsisë, synimet e dukshme aneksioniste dhe agresiviteti i monarkive ballkanike në kufijtë e territoreve të Perandorisë Osmane, nuk lejonin të veprohej për të synuar e siguruar menjëherë pavarësinë.³

Në rrjedhat e Kryengritjes Antiosmane të vitit 1912, Austro-Hungaria këshilloi Stambollin të gjente gjuhën e marrëveshjes me shqiptarët dhe të miratonte kërkesat e tyre për të mos agravuar situatën në rajon në dëm të të dy palëve. Nga ana tjetër, ajo u përgatit që, në çdo situatë, të realizohej krijimi i një shteti shqiptar, autonom ose të pavarur, i cili veçanërisht të kishte një shtrirje sa më të gjatë në vijën bregdetare, veri-jug. Ky shtet, sipas Vjenës, duhet të kishte një sipërfaqe të mjaftueshme për të mbijetuar dhe për të qenë i aftë të pengonte daljen në krahun e djathtë të kanalit të Otrantos, qoftë të monarkive ballkanike,

³ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll.II, f. 134, 193, 261, 293, 337-348, 443 etj.; *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, vitet 1878-1912.

posaçërisht të Serbisë (avanpostit të Rusisë në rajon), qoftë të Italisë, të kthyer në konkurrenca mjaft kokçarëse⁴.

Me shpërthimin e Luftës Ballkanike (8 tetor e filloi Mali i Zi, 17 tetor hyri Serbia, Bullgaria e me 18 tetor Greqia) dhe shpartallimin e shpejtë të trupave osmane, Ballplatzi u detyrua të nxitojë në mbrojtje të interesave të veta në rajon, e natyrisht veprimi edhe në të mirë të shqiptarëve. Austro-Hungaria, fuqishëm, i bëri të qartë Serbisë se nuk do të pranohej pushtimi prej saj i bregdetit shqiptar, se nuk do t'i lejohej as ndonjë rrip toke deri në det e as ndonjë port në Adriatik, duke kërcënuar se do të luftonte, qoftë edhe përballë Rusisë, duke tërhequr pas vetes edhe Gjermaninë e Italinë. Diplomacia e rafinuar e njëherësh e vendosur e Austro-Hungarisë argumentoi para të gjithë Fuqive të Mëdha, edhe përpara Rusisë, se në qoftë se Serbia vërtet synonte vetëm një dalje ekonomike në det, këtë mund ta realizonte fare lehtë e në mënyrë më rentabël përmes portit të Selanikut në Egje dhe hekurudhës Mitrovicë-Selanik, që të çonte atje. Argumenti i Beogradit për qejfmbetje apo kundërshtim nga ana e Bullgarisë nuk konsiderohej as e barasvlershme në Vjenë përballë kundërshtimit të saj për të hedhur poshtë kërkesën këmbëngulëse serbe për dalje në Adriatik⁵. Përballë këmbënguljes së Austro-Hungarisë, mbështetjes së saj veçanërisht nga Gjermania dhe në rrethanat e acarimit të situatës nga deklaratat e pa menduar ose testuese e diplomatit, përkatësisht ministrit serb, Millosh Bogiçeviq, të akredituar në Berlin, që guxoi të shprehej se Rusia nuk do të nguronte të hynte në luftë për të mbrojtur interesat e Serbisë, Petersburgu moderoi qëndrimin. Përmes ministrit të Jashtëm, Sazonov, ai u prononcua se deklaratat e diplomatit serb ishte e paautorizuar, dhe se nervozizmi që ajo shkaktoi ishte i justifikuar⁶.

Duke luajtur fort, siç luhet për çështje jetike, Austro-Hungaria e frenoi disi agresivitetin e fqinjëve, posaçërisht të Serbisë, e vuri në provë Italinë, e preku në sedër Gjermaninë, e bëri të kujdesshme e dëshiruese si asnjëherë të mbajtjes së ekuilibrit Britaninë, e vuri në dilema Francën dhe e uli me këmbë në tokë, në mos e trembi, Rusinë. Në sajë të kësaj politike

⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, vëll. II-IV; Shih edhe *AIH*, Arkivi i Vjenës, mars-korrik 1912.

⁵ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, vëll. VI.

⁶ *Po aty*, vëll. VI, Telegram i dt. 7.XII.1912 i ambasadorit austro-hungarez, Szögyeny, nga Berlioni. Shih për më gjerë korrespondencën diplomatike të muajit nëntor.

të fortë të qeverisë austro-hungareze, posaçërisht të diplomacisë së saj të kryesuar nga konti energjik Berchtold, shqiptarët, edhe pse në mbledhjen e Shkupit më 14 tetor (dita që filloi sulmin ushtria serbe në frontin e Merdarit në veri të Podujevës), nuk bënë më tepër se të vendosnin për të luftuar për tërësinë territoriale dhe lirinë e Shqipërisë dhe, të çoroditur nga zhvillimi i shpejtë i ngjarjeve, nuk u dëshmuan të njësuar në organizim e mendim se ç' duhej bërë, patën pranë dorën e një shteti të madh, që do t'i ndihmonte të shkonin drejt Shpalljes së Pavarësisë dhe të njohjes ndërkombëtare të shtetit të tyre të ri⁷.

Duke e konsideruar domosdoshmëri krijimi i këtij shteti të ri, qoftë edhe jo me kufij që të përfshinin gjithë trevat shqiptare (sepse në filozofinë e kohës fitimtarët patjetër do të duhej të shpërbleheshin dhe parimi etnik nuk ishte aq i vlerësuar në caktimin e kufijve sa të merrej në konsideratë), Vjena krahas të preferuarit të vet, Syrja Vlorës, i dha mbështetjen për të ndërmarrë hapat e duhur edhe Ismail Qemalit. E ndërsa i pari dështonte në misionin e madh, I. Qemali, pas udhëtimit të gjatë të njohur, që filloi nga Stambolli, mbledhi bashkëpunëtorët, siguroi në Budapest e Vjenë përkrahjen e domosdoshme dhe zbarkoi në Shqipëri. Takimet me diplomatët e lartë austro-hungarezë, e veçanërisht me Berchtoldin, por edhe ndoshta informimi se Stambolli nën ndikimin e Vjenës, ishte ndërgjegjësuar për të mos penguar hapat e shqiptarëve, i hapën dritën jeshile I. Qemalit dhe grupit që e shoqëronte, të niseshin për përmbushjen e misionit të paracaktuar, me bindjen se do të arrihej suksesi, sepse ishte siguruar mbështetja e vendosur e një fuqie të madhe. Ndërsa nisej drejt Triestes për të marrë anijen që do ta çonte në Shqipëri, I. Qemali telegrafoi se duhej nxituar për thirrjen e Kuvendit, sepse,

⁷ *Po aty*, vëll. V, VI, Korrespondenca diplomatike e muajve tetor-nëntor; shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 504. Në Shkup u mbledhën përfaqësues të Komitetit “Shpëtimi”, të “Shoqërisë së Zezë për Shpëtim”, përkatësisht Sali Gjuka, Nexhip Draga, Bedri Pejani, Mit’hat Frashëri etj. Për këtë mbledhje ishte marrë më parë edhe miratimi i Hasan Prishtinës dhe i Bajram Currit, të cilët ishin nisur për organizimin e mbrojtjes së tokave shqiptare nga mësymja e Serbisë dhe e Malit të Zi. Më 16 tetor Fuqive të Mëdha iu dorëzua deklarata ku theksohej se “populli shqiptar po i kapte armët jo për të forcuar sundimin e Turqisë në Ballkan, por për t'i dalë për zot tërësisë tokësore dhe lirisë së Shqipërisë ... shqiptarët nuk do të pranonin për katër vilajetet veçse një formë të vetme qeverisjeje”.

sikurse shkruante ai, “e ardhmja e Shqipërisë ishte siguar”⁸. I.Qemali avancoi edhe më tej nga qëndrimet e deriatëhershme për hapin që duhej bërë. Dëbimi i Perandorisë Osmane nga Ballkani, që për diplomatin me përvojë ishte gjë që shihej qartë, ja humbte kuptimin synimit për të arritur autonominë. Nga Triestja, para se të nisej me vaporin austriak drejt Durrësit, duke shprehur me sa duket edhe pikëpamjen e Berchtold-it, ai deklaroi se e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes shqiptare ishte ajo e Shpalljes së Pavarësisë⁹.

Ndoshta në atë moment I.Qemali nuk e dinte, por duhet ta ketë mësuar më vonë, se Vjena kishte marrë edhe masa të tjera nëse misioni i tij do të dështonte, nëse nga zhvillimi i shpejtë i ngjarjeve ushtarake në terren nuk do të bëhej e mundur që shqiptarët të organizonin një kuvend ku të merrnin vendimet e rëndësishme. Për shumë arsye, Shkupi nuk e luajti dot rolin e madh, por a do ta luante dot atë ndonjëri nga qytetet bregdetare të Shqipërisë? Berchtoldi nuk mund t’i lejonte vetes të papritura të mëdha të pakëndshme, prandaj në dhjetëditëshin e dytë të nëntorit, përmes nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, Rudney-t, u përgatit të kishte në duar një kartë të fortë, për ta hedhur në tryezën e bisedimeve të të mëdhenjve kur të vendosej për fatet e Ballkanit. Përmes Dom Kaçorrit, prelatit atdhetar të njohur të asaj dioqeze, Rudnei bashkoi firmat e 7-8 delegatëve shqiptarë, që ndodheshin aty në pritje për të shkuar në Kuvendin e madh të pritshëm (Nikoll Kaçorri, Mustafa Kruja, Rexhep Mitrovica, Fuat Toptani, Abdi Toptani, Murat Toptani, Sali Gjuka, Bedri Pejani), në një dokument të hartuar me një shqipe të pastër e një kaligrafi të bukur, që kërkonte nga Perandori i Austro-Hungarisë të mbronte interesat e Shqipërisë e të shqiptarëve¹⁰.

Hapat e tjerë të I.Qemalit dhe dhjetra delegatëve që u mblodhën në Vlorë dhe, më 28 nëntor 1912, shpallën Pavarësinë, janë të njohura. Mbështetja e vazhdueshme e Austro-Hungarisë, gjatë këtyre hapave, por

⁸ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, vëll. VI, f. 171, 172, Telegram i I.Qemalit, dt. 9 nëntor 1912 dhe korrespondencë midis Vjenës dhe konsullit në Vlorë, Lejhanec, dt. 13 nëntor 1912.

⁹ *Po aty*, f. 114.

¹⁰ *Po aty*, f. 173, 175, 177, Korrespondencë midis Vjenës dhe nënkonsullit Rudney në Durrës si edhe teksti i “Lutjes” së disa delegatëve shqiptarë me në krye Dom Nikollë Kaçorrin.

edhe më pas në Konferencën e Londrës, që përcaktoi statusin dhe kufijtë e Shqipërisë, gjithashtu janë përgjithësisht të njohura¹¹.

Do të vliente të nënvizohej se ende pa u mbledhur Konferenca e Londrës, më 17 dhjetor 1912, Vjena e kishte përcaktuar qëndrimin e vet për çështjen shqiptare, përballë synimeve të ballkanasve dhe Fuqive të tjera të Mëdha, madje e kishte shfaqur qartë dhe ashpër qëndrimin e vet. Konti Berchtold kishte këmbëngulur përmes stafit të vet diplomatik të akredituar kudo në Evropë e Ballkan, qysh në tetor, e veçanërisht në nëntor të vitit 1912, se do të duhej të *pranohej ekzistenca e një shteti shqiptar*, dhe se *nuk do të lejohej dalja e Serbisë në Adriatik* përmes tokave shqiptare. Duke akorduar me aleatët, Gjermaninë e ftohtë¹² dhe Italinë e shuminteresuar për rajonin¹³, Vjena kishte kërcënuar veçanërisht në drejtim të Rusisë, se për dy problemet e nënvizuara nuk mund të diskutohej dhe *negociata pranonte vetëm për çështjen e kufijve*.¹⁴

Korrespondenca dhe demarshet e diplomacisë austro-hungareze janë përplot me telegrame e raporte të Ballplatzit për ambasadat, legatat dhe konsullatat e saj dhe anasjelltas, ku evidentohen orientime, takime, debate, lobime dhe çdo veprimtari tjetër deri te informacionet nga viset shqiptare dhe rajoni. Përditë, madje shpesh disa herë në ditë, midis ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, kontit Leopold von Berchtold dhe ambasadorëve të vendosur në kryeqytetet e Fuqive të Mëdha si Szogyeni (Szögyeny) në Berlin, Mensdorfi (Mensdorff) në Londër, Meri (Mérey) në Romë, Thurni (Thurn) në Peterburg, Zvideneku në Uashington, Szeceni (Szecsen) në Paris, Pallaviçini (Pallavicini) në Stamboll, gjithashtu ministrave të akredituar në legatat në vendet e

¹¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2007; Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1978; *AIH*, Dokumente diplomatike të Arkivit të Vjenës, vitet 1912-1913.

¹² *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, vëll.VI, Telegram i ambasadorit Szögeny, dt. 5.XII.1912, për prononcimin e sekretarit gjerman të shtetit për punët e jashtme Alfred von Kiderlen, kundër daljes së Serbisë në Adriatik.

¹³ *Po aty*, Telegram i Szögyenit nga Berlioni, dt. 5.XII.1912 mbi prononcimin e markezit Di San Giuliano, ministrit të Jashtëm të Italisë, për të mos lejuar daljen e Serbisë në Adriatik.

¹⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, vëll.VI, Korrespondenca e Vjenës me ambasadorin në Peterburg lidhur me bisedat etij me ministrin e Jashtëm rus, Sergej Dimitrijeviç Sazonov.

Ballkanit si Fërstenberg-u (Furstenberg) në Bukuresht, Tarnovski në (Tarnovski) Sofje, Brauni në Athinë, Urgan në Beograd, Giesli në Cetinë dhe, veçanërisht me konsujt me shërbim në viset shqiptare, si Lejhanec në Vlorë, Rudnei (Rudnay) në Durrës, Bilinski në Janinë, Zambaur në Shkodër, Heimroth në Shkup etj., përditë pra, gjatë gjithë nëntorit dhe dhjetorit, vijonte korrespondenca diplomatike. Në këto dokumente konstatohet qartë se pozicionimi i mbajtur nga Austro-Hungaria pas 17 dhjetorit, në vijat kryesore ishte paracaktuar. Qëndrimi i Britanisë për një Shqipëri autonome dhe i Francës për një shtet shqiptar ndikoi që edhe Rusia të miratonte në parim qysh para Konferencës krijimin e një shteti shqiptar (autonom ose të pavarur)¹⁵.

Berchtold-i pyetjeve të bëra nga ambasadori rus, në emër të ministrit Sazonov, për një varg çështjesh u ishte përgjigjur se: “1. Marshimi i bullgarëve drejt Stambollit nuk i interesonte. 2. Ndarja e territoreve duhet të mos cenojë interesat tona ekonomike dhe populli shqiptar të mëvetësohet... 3. Nuk jemi kundër që Shkupi t’u mbetet serbëve. 4. Murgjit rusë në Malin Athos të mbeten si më parë, 5. Çështja e korridorit serb për në Adriatik është delikate për ne... nuk mund të pranojmë një zgjerim tokësor të serbëve në kurriz të Shqipërisë...”. Por dalja e Serbisë në Adriatik përmes viseve shqiptare u bë një nyje gordiane, që konsumoi shumë energji. Kurse për kufijtë, hartat mbi të cilat do të diskutonte përfaqësuesi i Vjenës në Londër, (7 harta skica, nga dy për Serbinë e Bullgarinë dhe tri për Shqipërinë) u porositën më 13 dhjetor dhe u përgatitën shumë shpejt nga Instituti Gjeografik Ushtarak diku rreth 14-17 dhjetorit (madje më 17 dhjetor u paguan dhe honoraret), pra në prag të Konferencës së Londrës.¹⁶

Sipas Ippen-it (shef seksioni në Ministrinë e Shtëpisë Perandorake dhe të Jashtme) në korrespondencën me Ludvig von Taloshin (Thalloszy) (shef seksioni të Tregtisë në Ministrinë e Përbashkët të Financës) dhe të këtij me konsullin e përgjithshëm në MPJ të Austro-Hungarisë, Rappaport, në harta u përfshinë brenda Shqipërisë së konceptuar nga Vjena, territoret jugore deri në Janinë. Ipen i theksonte Rappaportit më 14-

¹⁵ *Po aty*, Prononcimi i E. Grei (Edward Grey), sipas telegramit të Mensdorffit të datës 5.XII.1912. Qëndrimi i kryeministrit Poincaré (Puankare), deklaruar ambasadorit austro-hungarez Szechen, 6.XII.1912.

¹⁶ *Po aty*, vëll. VII, Korrespondencë e 14-16 dhjetorit 1912, e konsullit të Përgjithshëm Rappaport me Ipenin dhe Taloshin.

16 dhjetor 1912 duke i komentuar ato se “Delvina, Gjirokastra dhe Korça nuk duhet të mbeten jashtë”¹⁷.

Varianti i Austro-Hungarisë për kufijtë e Shqipërisë, i paraqitur edhe grafikisht më 20 dhjetor 1912 në Konferencë, është i njohur dhe shumë herë i botuar, madje te ne edhe në tekste shkollore. Ai ishte më i favorshmi për shqiptarët, edhe pse nuk përfshinte një pjesë të madhe të trevave kombëtare shqiptare verilindore e lindore. Duke synuar një vijë bregdetare sa më të gjatë të shtetit të ri, në përputhje edhe me synimet për të shmangur rënien e bregut lindor të Adriatikut në duart e shteteve të tjerë të Ballkanit, veçanërisht të Serbisë, Austro-Hungaria toleroi, ose më saktë bëri lëshime në viset e brendshme shqiptare. Ndoshta, përveç interesit parësor për viset bregdetare dhe përballë faktit se fitimtarët nuk mund të liheshin pa u shpërblyer me toka shqiptare, në Vjenë, duke sakrifikuar trevat shqiptare lindore e verilindore, arsyetonin edhe mbi bazën e dy llogarive të tjera. Së pari, paria e viseve të lëna jashtë kufijve, për arsye edhe fetare, kishte kundërshtuar fort futjen e trupave ushtarake austro-hungareze në Bosnje, në vitin 1878 dhe në momentet e aneksimit të saj më 1908. Së dyti, popullsia e madhe dhe mjaft e lidhur me besimin islam e këtyre viseve do të ishte e vështirë të asimilohej dhe do të përbënte një element destabiliteti për Serbinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë.

Në kufijtë e shtetit të ri Vjena përfshiu fillimisht në juglindje edhe territore jo shqiptare, të cilat u llogaritën dhe do të shërbenin për kompensim gjatë përpjekjeve për të arritur konsensus me Rusinë, që paraqiti kufijtë më të ngushtë për Shqipërinë e Re (20 dhjetor 1912) të propozuara nga Fuqitë e Mëdha. (Territorin më të cunguar e paraqitën në propozimin e tyre shtetet e Ballkanit).¹⁸

Kështu, pasi kishte siguruar miratimin e të gjithë Fuqive të Mëdha, për çështjen e krijimit të një shteti shqiptar (fillimisht autonom), qysh në gjysmën e parë të nëntorit të vitit 1912, pasi shmangu me këmbëngulje të gjithë variantet që i siguronin Serbisë daljen në Adriatik, pasi kishte seleksionuar kandidaturat e papërshtatshme në përzgjedhjen e princit të huaj, që do të vihej në krye të Shqipërisë (u përjashtuan emrat e Markezit të Auletës, Albert Gjikkës (të Rumanisë), Ahmed Fuadit (të Egjiptit), dukës d’Urahut, don Aladro Kastriotit etj., diplomacia vjeneze e përqendroi vëmendjen në çështjen e përcaktimit të kufijve të shtetit të

¹⁷ *Po aty.*

¹⁸ Shih harta bashkangjitur kumtesës.

ri.¹⁹ Në përpjekjet për të realizuar synimet e saj gjeostrategjike me rastin e rikonfigurimit të ri të Ballkanit, Austro-Hungaria ofroi opsionin më të favorshëm për kombin shqiptar, por, sikurse kemi theksuar, parimet e kohës nga njëra anë nuk merrnin fort në konsideratë përkatësinë etnike të territoreve dhe, nga ana tjetër, pretendimet territoriale të fitimtarëve merreshin shumë në konsideratë. Pikërisht mbi këto kritere Vjena, përballë dëshirës së kamotshme të Malit të Zi për të aneksuar Shkodrën dhe mbështetjen që ai gjente te Franca e Rusia, u nxit të testonte qëndrimin e Krajl Nikollës, nëse ishte i gatshëm të përfitonte Shkodrën duke sakrifikuar në favor të Austro-Hungarisë, qafat e Lovçenit, që i shërbenin mbrojtjes strategjike të flotës ushtarake të Austro-Hungarisë, të dislokuar në Kotorr.²⁰ Piruetat aspak serioze të krajlit, sikurse më herët edhe pozicionimet e ndryshueshme të Sofjes e Athinës, që dëshmonin për kontradikta dhe për qëndrime të luhatshme, brenda aleatëve ballkanikë, e bënë Vjenën gjithnjë e më të vendosur për të këmbëngulur në pikëpamjen e vet rreth rikonfigurimit të rajonit. Konferenca e Londrës ishte arena e luftës diplomatike, por për shumicën e çështjeve konsensusi ishte i rakorduar qysh para 17 dhjetorit të vitit 1912.

Koniunkturat apo fati i kishte siguruar shqiptarëve një aleat të fuqishëm dhe, kështu, edhe mundësinë për të mbijetuar.

*

* * *

Austro-Hungaria e kishte marrë në duar çështjen shqiptare si një çështje me rëndësi strategjike për të ardhmen e saj e të Ballkanit. Ishte fat i shqiptarëve, përkatësisht i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që, në një moment aq crucial, kur shumëçka u rrokullis me shpejtësi, kur dekada të


¹⁹ *Po aty*, vëll. VI, VII; Shih edhe *AIH*, Arkivi i Vjenës, korrespondenca diplomatike në dhjetor 1912-mars 1913.

²⁰ *Po aty*, vëll. VI, f. 207, 225, 226, 234, 274, Korrespondencë e datave 18-21 nëntor 1912 midis Berchtold-it dhe ministrit Giesl, të akredituar në legatën austro-hungareze në Cetinë. Telegram sekret i dt. 16 nëntor 1912, Giesl, duke raportuar lidhur me synimet e Nikollës, dredhitë dhe qëndrimin pa dinjitet dhe gatishmërinë për të tradhtuar e përfituar në çdo krah që t'i jepej mundësia shkruante se “me lajka e lëpirje qeni, hipokrizi e paturpësi u shpreh se është mik i Austro-Hungarisë e që do të jetë si kukull në dorën e saj.... Për ta lënë Serbinë në baltë ai është gati në çdo moment, mjafton vetëm sa të nxjerrë nga zjarri gështenjat e veta puna e tij qëndron këtu: të shkeli toka sa më shumë të jetë e mundur Prandaj lëpihet qenërisht...”.

tëra pune, përpjekjesh e gjaku, mund të shkonin kot, të kishte në krah një fuqi si Perandoria Austro-Hungareze, për t'i dhënë mbështetjen që të përmbushte njerën pjesë të programit të rilindësve, krijimin e shtetit shqiptar të pavarur.



Hartë – Kufijtë e shtetit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)



*Kufijtë e Shqipërisë sipas projektit fillestar të Austro-Hungarisë
në Konferencën e Londrës (1912-1913)*



*Kufijtë e Shqipërisë sipas projektit fillestar të Rusisë
në Konferencën e Londrës (1912-1913)*